



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.06.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidatët e propozuar për anëtar të Komisionit të Konkurrencës me VKM-në nr. 388, datë 9.6.2022.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Benet Beci, Antoneta Dhima, Enslemvera Zake, Anila Denaj, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj, Bujar Leskaj, Dashamir Shehi, Etjen Xhafaj dhe Ilir Topi.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Erion Braçe, Vullnet Sinaj, Alban Xhelili, Edmond Spaho, Agron Shehi, Jorida Tabaku, Emilja Koliqi dhe Shpresa Marnoj.

Të ftuar:

Ervin Myftaraj - Kandidat

Pajtim Melani - Kandidat

Durim Kraja - Kandidat

Leida Matja - Kandidate

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me kandidatët e propozuar për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës në përputhje me përcaktimin e dispozitave të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar” është organi më i lartë i vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës, dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe dy anëtarë propozohen nga Kuvendi.

Aktualisht, rezulton se i ka përfunduar mandati 5-vjeçar zonjës Juliana Latifi, e zgjedhur si anëtare me vendimin e Kuvendit të datës 15.12.2016, si dhe zonjës Leida Matja, e zgjedhur si anëtare e Komisionit të Konkurrencës me vendimin e Kuvendit, datë 23.3.2017. Të dy këta anëtarë janë propozim i Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” Kuvendi i është drejtuar me shkresë Këshillit të Ministrave, duke e njoftuar paraprakisht për përfundimin e mandatit të anëtarëve të komisionit.

Këshilli i Ministrave i ka përcjellë Kuvendit vendimin e tij nr. 388, datë 9.6.2022 “Për propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë së kandidaturave alternative për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës”.

Referuar relacionit që është në dispozicionin tuaj rezulton se procedura është iniciuar në datën 2 mars 2022, nëpërmjet publikimit dhe njoftimit për kandidim në faqen zyrtare të Kryeministrit. Duke qenë se në përfundim të afatit të përcaktuar nuk arriti të plotësohej numri i kandidatëve, sipas parashikimeve ligjore, afati për paraqitjen e kandidatëve është shtyrë për datën 21 maj 2022. Në përfundim të procedurës së ndjekur nga Këshilli i Ministrave i janë propozuar Kuvendit kandidaturat si më poshtë vijon. Për anëtarin e parë kemi dy kandidatura, zonjën Leida Matja dhe zotit Ervin Myftaraj. Ndërkohë për anëtarin e dytë kemi zotin Durim Kraja dhe zotin Pajtim Melani. Pasi janë marrë nga shërbimet e Monitorimit të Kuvendit në dorëzim CV-të e kandidatëve, duke iu referuar ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është konkluduar se personat i plotësojnë kriteret për të kandiduar për këto pozicione vakante.

Ne do të hapim diskutimet me kandidatët e propozuar.

I pari në radhë është zoti Ervin Myftaraj, të cilin e falënderoj për praninë!

Fjalën e ka zoti Myftaraj për të na bërë një prezantim të shkurtër të karrierës për të vijuar më tej me pyetje nga ana e kolegëve deputetë.

Më pas të bëhet gati kandidatura e dytë zoti Pajtim Melani. Më pas fjalën do ta kenë zoti Durim Kraja dhe në mbyllje zonja Leida Matja.

Fjala për ju zoti Myftaraj.

Ervin Myftaraj – Përshëndetje, i nderuar kryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Unë jam Ervin Myftaraj. Kam mbaruar Fakultetin e Ekonomisë në vitin 2008 dhe që nga ai vit jam emëruar si pedagog me kohë të plotë në Universitetin e Durrësit dhe tashmë janë bërë 14 vjet punë. Aktualisht jam përgjegjës i Departamentit të Marketingut, kam titullin “Doktor i Shkencave” dhe “Profesor i Asociuar”. Gjatë këtyre viteve kam marrë pjesë në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Kam disa botime shkencore si brenda dhe jashtë vendit në kuadër të punës sime, por edhe të studimeve që unë kam bërë.

Nuk e di nëse duhet të flas më shumë për karrierën apo ta lë me kaq?

Eduard Shalsi – Mund të na jepni 2-3 momente kryesore të karrierës suaj dhe pse keni vendosur të kandidoni për këtë pozicion të rëndësishëm.

Ervin Myftaraj – Nëse do të veçoja një moment të rëndësishëm në karrierën time është fakti që në moshën 30-vjeçare jam bërë “Profesor i Asociuar”, dhe “Doktor i Shkencave”. Me sa kam parë dhe hulumtuar kam qenë ndër më të rinjtë që e kam marrë këtë titull, pasi plotësova të gjitha kushtet ligjore që duheshin dhe që nga ai moment kam parë që gjërat për mua kanë ndryshuar. Jam ende i ri në moshë, por ndërkohë paraqitem goxha i vjetër nëpër tavolinat ku marr pjesë, duke paraqitur universitetin apo departamentin që kryesoj.

Sa i takon pozicionit të kandidimit, meqenëse u bënë kaq vite në këtë punë, mendoj se ndoshta ka ardhur momenti për të dhënë një kontribut më kombëtar sesa thjesht në një universitet. Unë mendoj që mund të jap më shumë dhe kjo është arsyeja që paraqita kandidaturën time për këtë post.

Eduard Shalsi – A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Resulaj.

Më pas fjalën e ka zonja Koti.

Pranvera Resulaj – Faleminderit!

Së pari, uroj kandidatin!

Sigurisht kushdo që vjen nga bota akademike është i mirëpritur në këtë komision, pasi shumë prej nesh kanë pasur jetë akademike.

Ju thatë që keni gradën shkencore “Doktor” dhe titullin “Profesor i Asociuar”, sikurse e përmendët edhe vetë, në një moshë shumë të re. Do të doja më specifikisht fushën tuaj të studimit dhe sa përputhet ajo me Autoritetin e Konkurrencës dhe me aktivitetin e tij?

Faleminderit!

Ervin Myftaraj – Faleminderit!

Fusha ime e studimit është fusha e marketingut dhe në këtë fushë një nga shtyllat kryesore që trajtohet marketingu është çmimi, jo vetëm çmimi, por edhe të drejtat e konsumatorëve. Ne i trajtojmë ato në bazë të konventave ndërkombëtare edhe në legjislacionin shqiptar dhe shumë prej këtyre të drejtave janë implementuar dhe zbatohen. Në këtë këndvështrim unë gjej lidhjen midis fushës sime të thelluar të studimeve me këtë komision, jo vetëm në mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve, por edhe në aspektin e vendosjes së çmimeve nga tregu, të monitorimit të çmimit nga tregu, si dhe të konkurrencës së lirë në një treg të lirë.

Eduard Shalsi – A ka ndonjë koleg tjetër pyetje?

Zonja Koti.

Më pas zonja Zake dhe zoti Shehi.

Sorina Koti – Urime, zotit Myftaraj!

Edhe unë vij nga bota akademike, kështu që kur pashë CV-në tuaj dhe që keni qenë i angazhuar me SAIFI-n, ju përgëzoj, sepse kemi qenë në një skuadër!

Do të doja më shumë të dija paanësinë politike, sepse di që anëtarët e Autoritetit të Konkurrencës duhet të jenë të paangazhuar politikisht për të mbrojtur konsumatorin, por në këto kushte që jemi në Shqipëri patjetër që politika influencon. Do të doja të dija pozicionin tuaj, nëse do të ketë hetime, vendimmarrje, të cilat do të jenë në të mirë të konsumatorit, por të ndikuara politikisht?

Eduard Shalsi – Mbajini pyetjet shënim dhe përgjigjuni më pas.

Zonja Zake.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Meqenëse ju po kandidoni për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, a keni njohuri se cili është roli i Autoritetit të Konkurrencës në rregullimin dhe reformën rregullatore?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Shehi.

Dashamir Shehi – Gjithë këtë karrierë e paskeni bërë shumë shpejt, urime!

Gjëja më e rëndësishme është se çfarë do të bësh kur të shkosh atje, sepse me letra na e kaloke edhe neve meqë që në moshën 30-vjeçare ke marrë titullin Profesor. Unë jam 65 dhe mazalla se më bëjnë! Po bëj shaka.

Çfarë do të bësh atje? A e di se cila është filozofia e kësaj pune, përveç asaj që the që dëshiron ta ndërrosh pozicionin e të tjera, ti do të bësh karrierë si të gjithë ne këtu, karriera nuk është turp po të jesh i zoti. Për mua përgjigja më e ndershme, pse do të shkosh atje, është se e quaj shkallë karriere dhe investim personal dhe kjo është mëse normale.

Para se të shkosh atje duhet të na thuash dy fjalë se çfarë do të bësh, të gjitha të tjerat i the, çfarë ke qenë e të tjera. Atje shumica janë njerëz partie, nëpër këto vende shkojnë ata që kanë kaluar në Komisionin Zgjedhor dhe partia si shpërblim u jep ndonjë vend, jo vetëm partia që është sot, por edhe e vjetra këtë punë bënte.

Po t'i shohësh me emra, të gjithë ata nga Komisioni Qendror Zgjedhor shkojnë. Ti nuk vjen nga Komisioni Zgjedhor, por a ke ti kurajë të përplasësh me ata, hajdutët e grurit, të misrit e të naftës?

Ervin Myftaraj – Ju falënderoj për pyetjet!

Sa i takon SAIFI-t ka qenë vërtetë një eksperiencë shumë e bukur. Unë kam qenë edhe *Facultit Adviser* në Universitetin e Durrësit për 3 vjet, për aq kohë që ishte ekzistent, sepse më pas u mbyll si projekt. Në lidhje me pozicionimin tim në vendimmarrjet e këtij komisioni, ju siguroj që në jetën time nuk kam qenë pjesë i asnjë lloj angazhimi politik, forumi apo krahu politik, pasi hyj te pjesa gri e elektoratit, pra tek ajo pjesë që vlerëson dhe shikon situatat në bazë të asaj ofrohet për Shqipërinë. Ka shumë gjëra për t'u bërë, edhe pse janë bërë shumë gjëra të mira, por absolutisht nuk e shoh veten të pozicionuar politikisht. Edhe nëse do të jem pjesë e këtij komisioni vendimmarrjet që do të marr do të jenë në dobi të interesit të publikut.

Në lidhje me rolin e Autoritetit të Konkurrencës, e kam parë bazën ligjore dhe te baza ligjore shoh që ndoshta ka hapësira për të ndërhyrë. Autoriteti i Konkurrencës të gjithë funksionin e vet e bazon në 3 shtylla kryesore, të cilat më së shumti qëndrojnë në hetimin e tregjeve kundrejt monopoleve apo karteleve të ndryshme që mund të ndodhin, pra marrëveshje të fshehta, në treg. Nëse do të jem pjesë e komisionit, mund të kem ndonjë propozim që autoriteti i

këtij komisioni të zgjerohet akoma më shumë dhe të ketë më shumë funksione, sepse me kaq funksione fusha e veprimit është pak e cunguar.

Në lidhje me kontributin konkret që unë mund të jap, zoti Shehi, sot është e kotë të bëj premtime, por e vetmja gjë që mund t'ju them është se do të jem vetvetja dhe njohuritë që kam t'i vë në zbatim të punës së këtij komisioni.

Në lidhje me atë që thatë, pra sa u takon anëtarëve që zgjidhen në këtë komision, a janë pjesë e krahëve politikë, më vjen keq, por nuk mund t'jua pranoj se nuk jam i tillë. Unë kam ardhur sot si vetvetja, njoh pak ose aspak nga politika, por nuk kam fare lidhje me politikën.

Jam emëruar lektor në vitin 2008, vit në të cilin ka qenë një krah tjetër politik, por kjo nuk ka fare lidhje. Unë i kam përfunduar studimet me një mesatare mjaft të lartë dhe kjo ka qenë arsye që më kanë marrë në punë. Një arsye tjetër ka qenë që në atë kohë Universiteti i Durrësit po rritej nga ana sasiore dhe kishte nevojë për lektorë.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

A ka ndonjë koleg tjetër pyetje? Nuk ka.

Ju falënderoj për praninë tuaj zoti Myftaraj!

Ju uroj suksese dhe mbarësi sido që të jetë ecuria!

Të njoftohet zoti Melani.

Të bëhet gati zoti Kraja.

Ervin Myftaraj – Faleminderit dhe punë të mbarë!

Eduard Shalsi – Mirë se erdhët, zoti Melani!

Zoti Melani është kandidati tjetër i propozuar për anëtar të Komisionit të Konkurrencës.

Do të ndjekim të njëjtën praktikë si me paraardhësit dhe pasardhësit, pra, do të na bëni një prezantim të shkurtër të karrierës suaj dhe në fund një shpjegim motivesh që iu shtynë për të konkurruar për një pozicion kaq të rëndësishëm.

Fjala për ju.

Pajtim Melani – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ekonomisë,

Për mua është e disata herë që ndodhem në këtë komision dhe sot është një kënaqësi e veçantë që ndodhem këtu për të konkurruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

CV-ja ime lidhet me më shumë se 16 vjet eksperiencë në fushën e konkurrencës. Unë kam qenë i drejtor i Mbikëqyrjes së Tregut në Autoritetin e Konkurrencës për një periudhë relativisht të gjatë nën drejtimin e zonjës Milo si kryetare. Më pas jam angazhuar dhe aktualisht jam ekspert në një projekt të Komisionit Europian që po zbatohet në Kosovës, duke ndihmuar autoritetin e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve në fushën e zbatimit të ligjit, ku si ekspert kam trajnuar stafin e Autoritetit dhe Komisionin e Konkurrencës së Kosovës lidhur me shtyllat kryesore të ligjit, abuzimin me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe kontrollin e përqendrimeve dhe të transaksioneve që ndodhin në treg. Ndërkohë, jam autor i manualit “Se si të përdorim ekonomiksin dhe metodat ekonometrike në rastet e abuzimeve me pozitën dominuese”, jam bashkautor i fjalorit “Të termave të konkurrencës”, një botim shumë i domosdoshëm për stafin e Autoritetit të Konkurrencës.

Gjatë periudhës që kam qenë në Shqipëri, sigurisht kam pasur mundësitë dhe fatin që të punoj si pikë kontakti me projektet e Bashkimit Europian, të jem pjesë e grupeve të punës për politikën kombëtare të konkurrencës në dy botimet e saj dhe pjesë e grupit për fjalorin e termave të konkurrencës. Unë kam studiuar Ekonomi dhe i kam përfunduar studimet në vitin 1998, ndërsa më pas kam mbaruar një master për administrim-biznes dhe vitin e kaluar kam përfunduar doktoraturën, pikërisht në fushën e konkurrencës me temën “Konkurrenca kundrejt stabilitetit në sistemin financiar” për shkak se një pjesë e karrierës sime lidhet me sistemin financiar, kryesisht me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Jam bashkautor i librit “E drejta e konkurrencës në Shqipëri”, një botim së bashku me zonjën Rezana Konomi, që sot është anëtare e Komisionit të Konkurrencës dhe i disa publikimeve të tjera në këtë fushë.

Lidhur me pikën pse mendoj që jam, do të thosha fjalën *fitting proper*, për këtë pozicion, besoj që kam eksperiencën e duhur, kam investuar në fushën konkurrencës prej kaq shumë vitesh, jam trajnuar pa fund, këto janë në CV dhe nuk po i përmend, nga BE-ja në SHBA, në vendet e rajonit e me radhë. Gjithashtu, edhe karrierën akademike ia kam kushtuar fushës së konkurrencës, duke e konkluduar me doktoraturën në këtë fushë.

Njoh mënyrën e investigimeve të Autoritetit të Konkurrencës, sigurisht që gjithmonë ka vend për përmirësim, pasi ligji ynë është një nga ligjet më të përputhura me *acquis communautaire*, por sigurisht që ka edhe disa instrumente që nuk janë zbatuar, si për shembull kontrollet e befasishme në ambientet private, të cilat bëhen me urdhër të gjykatës, disa çështje

për kontrollin e pritshmërive, qëndrimeve sigurisht që mund të rishikohen. Një çështje e veçantë, e shtuar në vitin 2018 në ligj, janë të drejtat ekskluzive dhe të veçanta, për zbatimin e të cilave duhet të merret miratimi i Autoritetit të Konkurrencës para se të akordohen, në mënyrë që të sigurohen që shërbime, të cilat janë realisht publike, mund dhe duhet të mbeten publike, por shërbimet që mund të gjenerohen më mirë nga privati, t'i mbeten privatit. Tregu jonë, për shkak të ekonomisë së shkallës, është i vogël, sfidat janë të konsiderueshme për një autoritet, i cili ka pasur mbështetjen e këtij komisioni për të forcuar kapacitetet. Unë kam ndjekur në mënyrë të vazhdueshme mbledhjet tuaja me autoritetin, vendimet, edhe për shkak të punës në Kosovë, shtimi i kapaciteteve, por sidomos trajnimi, por më e rëndësishmja mbajtja e personave të trajnuar me projekte të BE-së, do të ishte një vlerë e shtuar për autoritetin. Autoriteti sot drejton kapitullin 8 në negociatat me BE-në që është një ndër kapitujt më të debatueshëm të paktën me modelet e Kroacisë që është modeli që ne kemi marrë për të diskutuar me BE-në.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët deputetë?

Po, zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Zoti Kraja.

Eduard Shalsi – Ishte zoti Melani.

Pranvera Resulaj – Ndjesë!

Përgëzime për karrierën tuaj!

Ju thatë diçka që lidhet me ekonominë e shkallës, pra për shkak të ekonomisë së shkallës vendi ynë duke qenë një vend i vogël, a mund ta zhvilloni pak më tej si ide, sepse do të doja të dija opinionin tuaj për përcaktimin e ekonomisë së shkallës me një vend të vogël.

Pajtim Melani – Në fakt, ne kemi publikuar bashkë me një pedagog të nderuar një studim për mënyrën e zbatimit të ligjit dhe politikat e konkurrencës në ekonominë e vogla, siç është rasti i Shqipërisë, ku duhet thënë që për shkak të madhësisë së tregut numri i konkurrentëve si rregull është i ulët dhe kjo duket në shumë tregje, të cilat për shkak se nuk kanë një numër të madh konsumatorësh ose klientësh nuk mundësojnë aplikimin e ekonomisë së shkallës, pra nuk mundësojnë aplikimin e uljes së kostos për njësi. Kështu që kjo mbetet një sfidë për autoritetin e konkurrencës pikërisht për ta monitoruar.

Pranvera Resulaj – Ideja është që ekonomia e shkallës është kur numri është i madh. Thënia juaj “për shkak të ekonomisë së shkallës duke qenë një vend i vogël” m’u duk pak e paqartë.

Eduard Shalsi – Janë edhe disa kolegë që po e ndjekin online për shkak të disa impenjimeve të një agjende të përcaktuar, zoti Braçe, zoti Xhelili.

Zonja Dhima ka kërkuar fjalën.

Antoneta Dhima- Faleminderit!

Nuk është hera e parë që zoti Melani gjendet para këtij komisioni ku konkurruar për pozicione të ndryshme. Uën kam dy pyetje. Si e vlerësoni ju veprimtarinë e Komisionit të Konkurrencës? A ka ardhur koha të kemi disa ndryshime në ligjin organik për funksionimin e Komisionit të Konkurrencës, sepse është një ligj i vitit 2003?

Pajtim Melani – Sigurisht nuk marr tagrin të vlerësoj. Sigurisht teknikisht mund të them se disa çështje mund të shikohen. Unë kam qenë interaktiv në Kuvend me faqen e kryetarit, për shembull te rezoluta do të kisha propozuar që para se të bëhej rezoluta për institucionet e pavarura të kishte një lloj konsultimi, siç bën Komisioni Europian me ekspertë të fushës, me OJQ, dhe me organika të tjera. Parë në këtë këndvështrim do të sugjeroja që disa vendime të komisionit të mos ishin *copy paste* e ligjit, në kuptimin që nuk mund të shkruhet që ndalohet të shkelësh nenin 4 të ligjit për marrëveshje të ndaluara. Kjo nuk bën sens që do të thotë se do një lloj profesionalizmi edhe në vënien e kushteve dhe të detyrimeve. Së dyti, lidhur me përqendrimet që ndodhin jashtë territorit të Shqipërisë nuk kanë asnjë impakt në Shqipëri, janë thjesht kosto për biznesin, që nuk kanë sens të njoftohen dhe të notifikohen në Autoritetin e Konkurrencës sa kohë që ligji thotë se fusha e veprimtarisë së nenit 2 e Autoritetit të Konkurrencës është tregu në Shqipëri, pra, pavarësisht se mund të kenë xhiro shitjeje dhe po marr për shembull Samsungun, një transaksion që ndodh në Kore nuk ka pse të njoftohet në Autoritetin tonë. Kjo për t’i dhënë ekonominë e politikës dhe ligjit të konkurrencë dhe për t’u marrë me çështje më të rëndësishme se këto çështje. Por këto i kam opinione duke i parë nga jashtë dhe që mendoj se mund ta përmirësonin punën. Këtu mund ta gjej edhe veten për të qenë pjesë e këtij komisioni, pra për të dhënë ekspertizën për aq sa unë kam mundësi me njohuritë trajnimet dhe me fondet që ka shpenzuar qoftë buxheti i shtetit me trajnimet tona, qoftë edhe Komisioni Europian, pra për të rritur kapacitetet. Besoj se është shumë e qartë që kapacitet e

Autoritetit të Konkurrencës duhet të jenë në një tjetër nivel qoftë në vendimmarrje, qoftë në zbatim.

Unë, në fakt, mendoj se ligji i vitit 2003, i amenduar në vitin 2010, patjetër ka nevojë për ndryshime, një ndër të cilët do të thosha se është ndihma shtetërore e cila duhet t'i bashkohet Autoritetit të Konkurrencës. Kemi një ligj për ndihmën shtetërore, e cila është në Ministrinë e Ekonomisë, ka atje një Komision të Ndhmës Shtetërore, por modeli i BE-së dhe modelet më të mira sugjerojnë që ndihma shtetërore duhet të jetë pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe kjo besoj se mund të jetë një nga ndryshimet e rëndësishme thelbësore. Ne kemi detyrimin në BE që të kemi një institucion të pavarur për ndihmën shtetërore dhe besoj se duke u atashuar te Autoriteti i Konkurrencës mund të jetë një zgjidhje efikase.

Eduard Shalsi – Zoti Melani, mbajtëm shënim atë që thatë për rezolutën, sepse mendojmë se midis Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe institucioneve të pavarura kemi hedhur një hap përpara duke u nisur nga eksperiencat e së kaluarës, duke marrë më të mirën e eksperiencave të së kaluarës, por edhe duke parë edhe mundësinë për një rol ende më *proaktiv* të Komisionit të Ekonomisë. Bashkë me kolegët deputetë jemi shumë të interesuar që jo vetëm proceset e rezolutës por në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me monitorimin e punës së institucioneve të pavarura ne të kemi një vijimësi dhe jo vetëm një herë në vit. Kështu që çdo lloj kontributi në këtë drejtim do të ishte më shumë se i vlerësuar.

Mbledhjen e ndjekin *online* një pjesë e deputetëve të komisionit, sipas praktikës së mbledhjeve hibride por ka edhe individë të tjerë që drejtojnë pyetje.

Ka dy pyetje, njëra është nga zoti Xhelili. Për të riparuar një dëm të madh në treg për shkak të kufizimit të konkurrencës, cili është instrumenti që përdor Autoriteti i Konkurrencës për ta ndaluar atë? Pak javë më parë në Shqipëri i zhvilluar finalja e një kupe që mori shumë vëmendje dhe një nga pikat e debatueshme ka qenë edhe fakti që po abuzohej me çmimet e hoteleve. Në fakt, edhe mes nesh ka pasur qëndrime të ndryshme dhe ju paskeni bërë një prononcim në medie apo jeni prononcuar diku. Do të doja të dija opinionin tuaj në lidhje me fenomenin sepse pati një tendencë edhe nga institucionet shtetërore përfshi Tatimet ose Autoritetin për të ndërhyrë për të monitoruar. Unë kam një parim tjetër, në fakt. Cili është opinionin juaj që për shkak të një ngjarjeje që prodhoi një kërkesë shumë të madhe, pati një kufizim ose numër të limituar dhomash dhe çfarë do të duhej të bëhej në rastin e rritjes së

çmimeve? Meqë pyetja vjen nga një ndjekës ai thotë se kandidati ka bërë një prononcim, të cilin unë nuk e kam dëgjuar, por doja ta dija.

Zoti Xhafaj ka kërkuar fjalën.

Etjen Xhafaj – Faleminderit!

Unë e vlerësoj kandidaturën e zotit Melani duke qenë se ka pasur disa pozicione dhe ka një eksperiencë në disa institucione që kanë lidhje jo vetëm me ekonominë, por edhe me aplikimin praktik të të gjithë kuadrit administrativ në këtë drejtim. Autoriteti i Konkurrencës shumë shpesh fatkeqësisht shihet si një polic, i cili duhet të reagojë në momentin që ka një stimul të jashtëm. Si mendoni ju që duhet të jetë roli i Autoritetit, në lidhje me autoritetet e tjera të cilët zbatojnë në kuadrin e legjislativ Tatimet, QKB-ja për të lehtësuar konkurrencën, jo vetëm për të parandaluar mosushtrimin apo mosveprimin e konkurrencës apo, le të themi ato që janë koalicionet e ndaluara sa i përket biznesit?

Eduard Shalsi – Me pyetjen e zotit Xhafaj e mbylлим seancën e pyetjeve.

Pajtim Melani - Sa i përket pyetjes së parë të zotit Xhelili: Për të riparuar një dëm të madh në treg për shkak të kufizimit të konkurrencës, cili është instrumenti që përdor Autoriteti i Konkurrencës për ta ndaluar atë? Një instrument për marrjen e masave të përkohshme që Autoriteti dhe Komisioni i Konkurrencës mundohet ta zbatojë për të parandaluar dhe për të frenuar abuzimin në pozitën dominuese ose një marrëveshje të ndaluar dhe ndërmarrja, e cila e zbaton, nuk e zbaton masën dënohet me gjobë të rëndë deri në 10% të xhiros është neni 44 i ligjit. Pastaj për kërkimin e dëmit është gjykata që është burimi i fundit për të kërkuar informacionin.

Lidhur me pyetjen për çmimin e hoteleve gjatë finales, unë kam bërë një ndërhyrje në rrjetet sociale, jo në medie, në kuptimin që Autoriteti funksionon në bazë të një ligji *antitrust* që do të thotë se merret vetëm me sipërmarrje që kanë dominancë në treg ose me marrëveshje të ndaluara. Kjo do të thotë se tregjet që kanë një numër shumë të madh operatorësh siç janë hoteleria B&B-ja, *bucking*, të gjitha këto platforma teorikisht ose tregjet e fermerëve që janë prodhues të qumështit ose të domateve, teorikisht janë jashtë është e pamundur që Autoriteti i Konkurrencës të merret me këto tregje. Ajo që ndodhi me çmimet në gjykimin tim, bazuar në eksperiencën të ngjashme të hetimit të *bucking*, sepse është kontrolluar nga Komisioni Europian, për shkak të dominancës që ka sepse është operatori që nuk ka asnjë hotel të vetin pro ka mbi 90% të hoteleve të listuar në *bucking*, funksionon si platformë e cila në bazë të klikimeve që

marrin kërkesat për çdo shërbim i famshëm që të çon te çmimi dhe nuk e di të hyjë Autoriteti në një hetim të tillë do të thotë t'i hynte detit në këmbë deh prandaj them se më shumë duhet fokusohet në çështje që e kanë mundësinë kapacitetet dhe ku duhet të ndërhyhet.

Sa i përket pyetjes së zotit Xhafaj, Autoriteti i Konkurrencës sigurisht që bashkëpunon me Tatimet në kuptimin që sa herë që ka gjetje të informalitetit dhe të deformimit të tregut për shkak të *fiskut*, siç mund të ishte dhe ky rast i hotelerive, mund të adresohet çështja tek Tatimet dhe pastaj Tatimet të bënin pjesën e vet në mbulimin e çështjeve. Po ashtu me QKB-në kemi një memorandum mirëkuptimi 2 herë në vit ne marrim të gjitha transaksionet që kanë ndodhur dhe që regjistrohen në QKB dhe nëse nuk janë njoftuar në Autoritet, në rastet kur ka ndryshuar kontrolli dhe plotësohen kriteret e xhiros atëherë ne fillonim procedurën me nismën tonë duke pasur këtë lloj bashkëpunimi dhe duke qenë si një skaner për çdo transaksion ka një databazë shumë të mirë.

Etjen Xhafaj – Vetëm për të bërë një sqarim, e kisha me një ligj specifik që ka të bëjë me njoftimin ose marrjen e informacionit nga ata që janë aksionerët e kompanive të mëdha që duhet ta çojnë personalisht që në fakt është e pazbatueshme duke i konsideruar kompanitë e mëdha që Shqipëri synon të tërheqë.

Eduard Shalsi – Zoti Milani, ju falënderojmë!

Kandidatura tjetër është zoti Durim Kraja.

Do të vijojmë si me kandidatët e tjerë, një prezantim konciz të karrierës suaj dhe çfarë ju motivon apo ju shtyu që të konkurroni për një pozicion të tillë të lartë. Pastaj fjalën e kanë kolegët për pyetjet e radhës.

Durim Kraja – Faleminderit!

Në fakt, është kënaqësi dhe privilegj për mua që pas shumë kohësh vi në komision. Mbase duhej të isha për të qenë pjesë e Bankës së Shqipërisë por për arsye personale e pata të pamundur të vija për të shpалosur programin tim në atë kohë. Për ata që nuk më njohin unë jam Durim Kraja. Kam mbaruar studimet e larta në vitin 1988 për ekonomi dhe financë dhe që nga ajo kohë kam punuar dhe gërshtuar në përvojën time p-personale administratën publike, akademinë dhe sektorin privat. Për shumë kohë bazuar në formimin tim profesional dhe akademik për arsye se në vitin 2004-2006 kam kryer studimet për master në administrim publiku, midis universitetit të Nebraskos dhe universitetit të Tiranës dhe më tej kam vazhduar procesin e marrjes së doktoratës që e kam përfunduar me sukses në vitin 2015, pranë po këtij

universiteti në shkencat ekonomike. Bazuar në këtë background profesional dhe akademik kam punuar në fusha të ndryshme të administratës publike. Që nga viti 2000 kam mbajtur pozicionin e drejtorit Ekonomik dhe Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe nga viti 2004 deri në vitin 2011 në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjetikës si sekretar i Përgjithshëm i saj.

Në fakt, e kam përvojën administrative dhe e kam gërshetuar gjithmonë me një përvojë të cilësueshme në fushën e akademisë. Kam qenë për një kohë të gjatë pedagog i jashtëm në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Ekonomisë dhe që nga viti 2017 jam pedagog i brendshëm, lektor më parë në universitetin “Qiriazi” dhe tani në universitetin “Metropolitan” të Tiranës, duke u fokusuar në shkencat e menaxhimit, gjithashtu edhe ekonomiks, si dhe në fusha të tjera të ekonomisë, që janë të rëndësishme, sidomos për sfidat që ka vendi ynë.

Kam një përvojë të gjatë, thuajse 30-vjeçare, administrative, ekonomike, akademike, po ashtu edhe në sektorin privat, pasi për shumë kohë kam qenë i atashuar pranë një studioje ligjore, e keni edhe në CV-në që unë kam depozituar, po ashtu edhe në aktivitetin privat familjar, për të ndihmuar çështjet ekonomike të familjes dhe për të ecur përpara.

Ajo që dua të theksoj në CV-në time ka të bëjë me faktin që, besoj në këtë kohë që them, karakterizohem nga energjia për t'i shkuar deri në fund një pune që marr përsipër dhe një nga veçoritë e mia, edhe pse është e vështirë të flasësh për veten, është që besoj se jam një komunikues i mirë me stafin, me eprorët, po ashtu edhe me vartësit.

Të punuarit për një kohë të gjatë si sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë më ka dhënë konfidencë në trajtimin e çështjeve të biznesit, në përgjithësi, por edhe ato që lidhen me konkurrencën, me mbrojtjen e konsumatorit, si dhe me ndihmën shtetërore.

Në fakt, është e thjeshtë të thuash se jam sot këtu sepse dua të kontribuoj, dua ta çoj përpara punën e Autoritetit dhe me radhë, ka shumë arsye për të qenë këtu, por unë e trajtoj, e besoj dhe e mendoj që kjo është një shkallë ngjitjeje në karrierë, pasi çdo njeri që punon, kalon, sfidon, në fund të fundit, ka dëshirë të ketë edhe arritje në karrierën e tij. Kjo është një nga arsyet që unë jam sot këtu.

Përtej kësaj, dua të theksoj faktin që 30 vjet nuk janë pak për të investuar, por në të njëjtën kohë, në formimin tim akademik, profesional, ky shtet ka investuar dhe, në njëfarë mënyre, unë dua që t'ia kthej, ndaj dhe unë po rikthehem, në qoftë se marr besimin tuaj dhe të parlamentit të nderuar, për të sfiduar veten, në radhë të parë, por edhe për të ecur përpara në formimin tim, për ambicien time për të qenë dikush në jetë dhe për të arritur shkallët e karrierës.

Kjo është një nga arsyet pse jam sot këtu dhe besoj se të qenit komisioner në Autoritetin e Konkurrencës më jep një mundësi për të shpalosur disa nga pjesët e vizionit tim që kam për këtë Autoritet, bazuar edhe në përvojën e mëparshme, por edhe për faktin që të konkurruarit sot këtu më ka mundësuar të familjarizohem me disa koncepte. Ndaj, besoj dhe mendoj se ky Autoritet ka sfida përpara dhe, duke qenë pjesë e tij, mund të bëhem pjesë e këtyre sfidave dhe, pse jo, për t'i kaluar dhe për t'i realizuar me sukses ato.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Kraja!

Atëherë, zonja Zake, zoti Rushaj, zonja Dhima dhe zonja Resulaj kanë kërkuar fjalën për pyetje.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Faleminderit, zoti Kraja, për prezantimin!

Meqenëse ju po kandidoni për anëtar të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, pyetja ime është: sa njohuri keni ju lidhur me rolin që Autoriteti i Konkurrencës ka në rregullimin dhe formën rregullatore?

Pyetja e dytë: çfarë do të bëni ju më tepër, duke qenë pjesë e Autoritetit të Konkurrencës, si vlerë e shtuar, përveç ambicies për karrierë, për të pasur një status tjetër, që ju përmendët, ose për të zhvilluar karrierën tuaj profesionale?

Faleminderit!

Durim Kraja – Në fakt, në prezantimin e shkurtër të jetëshkrimit tim, unë e përmenda faktin që për një kohë të gjatë kam qenë pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, në rolin e sekretarit të Përgjithshëm, e cila është një ministri kryesore për sa u përket politikave të konkurrencës, por përtej asaj, edhe mbrojtjes së konsumatorit dhe ndihmës shtetërore.

Përtej kësaj, meqenëse jam këtu sot, kam hulumtuar dhe shfletuar raportet e Autoritetit të Konkurrencës ndër vite dhe, gjithashtu, edhe pozicionin që ka ky Autoritet në konkurrencën në tërësi.

Në fakt, Autoriteti i Konkurrencës është një organ qendror për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës, nëpërmjet të cilës vendos rregulla të caktuara për aktorët që janë në treg, si dhe përgjegjësisë që kanë institucionet përgjegjëse për zhvillimin e konkurrencës. Në fakt, dhe kjo mund të jetë pjesë e pyetjes së dytë, lidhur me atë që unë mendoj si vlerë e shtuar, që modestish unë mund të them, është fakti që unë shikoj si qytetar, në radhë të parë, dhe pastaj si akademik

dhe si pjesë e proceseve që ndodhin në Shqipëri, që Autoriteti i Konkurrencës bazohet në një ligj, i cili është i përafuar me *acquis communautaire* dhe roli i tij sipas ligjit është shumë i rëndësishëm.

Ajo që ndodh lidhet me faktin që midis rëndësisë që jep ligji dhe pozicionit që sot ka Autoriteti, akoma nuk kemi një miks të pranueshëm, sepse perceptimi jo vetëm në publik, por edhe më gjerë është se Autoriteti, pavarësisht progresit që ka bërë, nuk ka shkuar në nivelin e kërkesës që jep ligji, për arsye se, nëse shohim, ligjin, ligji ka shumë pak gjëra për të përmirësuar. Ligji mund të trajtohet, se edhe detyra që vazhdimisht lë parlamenti i nderuar karshi Autoritetit të Konkurrencës, është të amendojë ligjin. Ligji mund të amendohet, kryesisht, për të shtuar fushën e veprimtarisë së Autoritetit, sesa për të qenë i përafuar me *acquis communautaire*. Pra, rëndësinë, që i jep ligji Autoritetit, ne duhet ta bashkërendojmë me rolin që ky Autoritet duhet të ketë, për të shkuar në lartësinë e ligjit. Kjo është sfida më e madhe që duhet të ketë.

Fushat që mbulon Autoriteti i Konkurrencës janë bazuar në 3 shtylla kryesore, që ju mund t'i keni dëgjuar edhe nga parafolësit, që kanë të bëjnë me marrëveshje të ndaluara, me përqendrime, gjithashtu me abuzimin e pozitës dominuese. Ne jemi vend i vogël. Duke qenë një vend i vogël, me një treg të reduktuar, të rënit në pozita monopol, në oligopol, të shkuarit drejt marrëveshjeve të ndaluara, është më e thjeshtë se në vendet e zhvilluara, në vendet që kanë një treg të hapur.

Do të ishte shumë më mirë që ne sot të diskutonim për disa shekuj më parë, për Adam Smithin, i cili thoshte se dora e fshehtë e tregut i rregullon të gjitha, por nuk është e vërtetë. Shpesh ndodh, jo në Shqipëri, por gjithandej që në vend që kompanitë, firmat të konkurrojnë me njëra-tjetrën, pra të luftojnë në treg për të dominuar njëra-tjetrën, mbi bazën e kushteve të barabarta, një pjesë e tyre bien në kompromise, të cilat, në një mënyrë ose në një tjetër fiksojnë çmimet, në një mënyrë ose një tjetër ulin cilësinë e produktit, kështu konsumatori detyrohet të ketë më pak zgjedhje dhe, ajo që është më e rëndësishme, nuk ka inovacion. Besoj se përtej kësaj, është e rëndësishme të themi që Autoriteti i Konkurrencës duhet të ketë një rol më të rëndësishëm për harmonizimin, sidomos, të tregjeve të rregulluara, sepse ne e dimë që një pjesë e mirë e sektorit ekonomik në Shqipëri, është e rregulluar, siç është AKEP-i, ERE, ERU-ja dhe me radhë.

Politikat e konkurrencës dhe politikat rregullatore nuk janë të njëjta, pasi politikat rregullatore, në njëfarë mënyre, kufizojnë konkurrencën, mbrojnë atë që është në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, por përtej kësaj, instrumentet e konkurrencës janë të përhershme, ndërsa instrumentet rregullatore janë të përkohshme, deri sa tregu të hapet, të zgjerohet. Në këtë kontekst, pavarësisht marrëveshjeve të nënshkuara midis Autoritetit të Konkurrencës dhe enteve rregullatore, duhet patjetër që roli i Autoritetit të Konkurrencës të jetë crucial, për sa i përket edhe monitorimit të këtyre tregjeve të rregulluara, se, në fakt, Shqipëria, ekonominë e saj e ka të bazuar në ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme e kanë shumë të vështirë të bien në pozita monopol dhe të bien në pozita oligopol. Ato, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën, janë kompanitë e mëdha publike, janë kompanitë e mëdha, të cilat krijohen mbi bazën e përqendrimeve të ndaluara, të cilat në një mënyrë ose në një tjetër, bëjnë të pamundur mbijetesën e këtyre ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun e konkurrencës dhe kjo është e rëndësishme për t'u nënvizuar.

Besoj se isha shterues.

Eduard Shalsi – Zoti Rushaj, fjala është për ju. Pastaj, fjalën e ka zonja Dhima.

Alfred Rushaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kraja, eksperiencia juaj është në të dyja anët e spektrit, le të themi. Pra, ju keni punuar edhe në sektorin publik, në një institucion që nxitjen e biznesit e ka pasur pjesë të veprimtarisë së tij, po ashtu ka pasur edhe mbrojtjen e konsumatorit, për të mos thënë që ka pasur edhe funksion rregullator, siç është komisioni i ndihmës shtetërore. Nga ana tjetër, keni punuar prej kohësh edhe si konsulent në biznesin privat. Pra, e keni të kompletuar në të dyja anët eksperiencën tuaj.

Ajo çka unë kam vënë re dhe besoj të gjithë ne këtu në komision, sa herë që ka qenë diskutimi, e kemi ngritur këtë si shqetësim, ashtu siç edhe ju thatë, është diferenca midis fuqisë që i jep ligji komisionit dhe rezultateve që ka pasur në treg vendimmarrja e komisionit. Ajo çfarë ne do të donim të dëgjonim, është mendimi juaj se ku mund të ndikoni, në mënyrë që rezultatet që do të ketë vendimmarrja e Komisionit, të mund të arrijnë apo të ngjiten në përgjegjësinë që Kuvendi i ka dhënë nëpërmjet kompetencave, që i ka dhënë nëpërmjet ligjit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Marrim edhe pyetjen e zonjës Dhima.

Zonja Dhima, fjala është për ju.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zot Kraja, për prezantimin!

Më vjen mirë që keni një eksperiencë profesionale dhe një vjetërsi pune, që plotësojnë kriteret e përcaktuara për këtë pozicion dhe njëkohësisht fitimin e gradës “Doktor” në një temë shumë të rëndësishme, e cila është e debatuar sot mbi koncesionin, si një mënyrë menaxhimi dhe financimi i shërbimeve publike.

Pyetja ime e parë është: cili është roli i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, kur evidentohen raste të rritjes së çmimeve në treg për produkte dhe shërbime të caktuara, pasi në raportimet vjetore, që janë bërë nga Autoriteti dhe njëkohësisht në dëgjesa, që ne si Komision i Ekonomisë dhe Financave kemi bërë, Autoriteti i Konkurrencës hap hetime të përgjithshme, hap hetime paraprake dhe të thelluara për tregjet përkatëse kur ka fenomene të rritjes së menjëhershme në të njëjtën masë të çmimeve, të cilat, sipas ligjit, konsiderohen shkelje, do të doja një opinion nga ana jua.

Së dyti, nëse Kuvendi i Shqipërisë do t’ju votojë për të qenë pjesë e Komisionit të Konkurrencës, a do të ndikoheni në realizimin e detyrës suaj si anëtar i Komisionit Konkurrence në marrjen e vendimeve, përveçse në detyrën tuaj funksionale?

Faleminderit!

Durim Kraja – Po fokusohem te pyetja që sapo bëri zoti Rushaj. Unë e përmenda që në fillim të prezantimit tim se roli që i jep ligji Autoritetit dhe perceptimi ose niveli në të cilin është sot autoriteti, nuk është akoma realizuar në një masë të pranueshme.

Pra, pyetja e zotit Rushaj ishte: cili është vizioni juaj se si mund të afrohet dhe përmirësohet ky *gap* midis rolit të ligjit dhe nivelit të AK-së? Nëse më lejoni, unë do të zgjerohem pak, duke marrë 2 apo 3 shembuj për sa i përket rolit që ka Autoriteti i Konkurrencës në Komisionin Europian. Në fakt, është një nga 43 drejtoritë e përgjithshme *DG Competition*, siç quhet, e cila, ndryshe nga ne, përfshin edhe politikën e mbrojtjes së konsumatorit dhe të ndihmës shtetërore, që përmendi zoti Rushaj.

Në rast se marrim disa çështje të rëndësishme, siç është rasti i gjobës së majme prej 4,37 miliardësh, që komisioni i vendosi *Google*-it për mënyrën e padrejtë të sistemit *android* për të minuar konkurrencën e konkurrentëve të tjerë për sa i përket kërkimit në *web*, unë do të përmend edhe një fakt tjetër. Sot Amazon është në një proces hetimi lidhur me faktin që, duke qenë *retailer*, vetëshitës, por edhe *market place*, ka punuar në dëm të kompanive që kanë ofruar

shërbimet dhe mallrat e tyre në këtë platformë, duke përdorur të dhëna konfidenciale të kompanive në dëm të tyre.

Përmenda këto shembuj, për të thënë se sa i gjerë është spektri i veprimtarisë së një autoriteti konkurrence në Europë, pse jo edhe në Shqipëri. Pra, mundësitë për të filluar një hetim të përgjithshëm apo hulumtim për indice apo një hetim paraprak dhe marrjen e masave të përkohshme apo të përhershme, janë të gjitha në dorën e komisionit.

Si mund të ndodhë kjo? E para, është e rëndësishme, zoti Rushaj, që komisioni, autoriteti të krijojë një perceptim tjetër në publik, pra që ka një pozitë kyçe për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës . Mbrojtja e konkurrencës nuk është vetëm për të mbikëqyrur rregullat e aktorëve në treg, siç janë ndërmarrjet publike dhe private, por edhe shtrembërimin e konkurrencës, që mund të ndodhë nga entet publike apo institucionet publike, siç është rasti i keqpërdorimit të ndihmës shtetërore apo edhe rasti i rritjes galopante të çmimeve, që shpeshherë debatohet në media nga politika.

Në këtë kontekst mendoj që barazia karshi të gjithë aktorëve në treg, transparenca, gjithëpërfshirja të jenë të besueshme, por edhe me integritet, gjëra këto që janë pjesë e punës dhe e përvojës sime që kam përfutuar ndër vite.

Lidhur me pyetjen për formimin tim akademik, është e vërtetë që gradën time shkencore unë e kam mbrojtur për partneritetet publike dhe private dhe jam i bindur kur them që PPP-të dhe koncesionet, si pjesë e rëndësishme e tyre për sa i përket mënyrës së përfshirjes të komponentit privat në iniciativa publike, kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, kanë të bëjnë me shtetin liberal dhe shtetin joprodhues dhe rregullator. Pra, asnjëherë PPP-të nuk duhet të quhen si një e keqe, por si një e mirë që mund t'i ndodhë sektorit publik, që përfshin kapacitete financiare, intelektuale dhe kapacitetet e punësimit. Në të kundërt shteti do t'i bënte vetë, por shteti i ka mundësitë e limituara, sidomos një shtet si Shqipëria.

Për sa i përket pyetjes për rritjen e çmimeve, mendoj që kjo rritje duhet parë si proces kompleks dhe jo ta marrim të veçuar sot. Ne mendojmë se jemi në një situatë jo normale, për arsye se jemi gati në luftë. E dimë shumë mirë që në momentin kur kemi konflikte rajonale dhe më gjerë, dhe në këtë rast mund të themi që është një konflikt përtej kuptimit rajonal, në përgjithësi aktorët dhe faktorët në treg spekulojnë dhe kjo ka të bëjë jo me spekulimet në Shqipëri, por me spekulime që mund të ndodhin përtej kufirit tonë.

Ajo që duhet të bëjë patjetër Autoriteti i Konkurrencës është të hulumtojë tregun dhe ta monitorojë.

Unë e kam lexuar raportin e fundit të vitit 2021, që ka bërë Autoriteti i Konkurrencës dhe vura re që në maj të 2021-ës kishte filluar një procedurë për sa i përket rritjes së çmimit të vajrave vegjetalë. Në fakt, akoma nuk është dhënë një vendim, kjo ka ta bëjë me faktin që duke vendosur në kohë dhe duke luftuar me kohën, mund të bëhesh i dobishëm. Pra, besoj se praktikrat *ex ante* duhet të koordinohen me praktikrat *ex post*, për arsye se *ex post*, ai që përfton, patjetër që është ekonomia në tërësi, por konsumatori ka humbur për një farë kohe. Në fakt, praktikrat *ex ante* janë shumë rëndësishme për të dhënë më tepër një opinion, siç mund të jetë një opinion i caktuar në lidhje me PPP-të në momentin që ato kanë të bëjnë me të drejtat ekskluzive apo me të drejta të veçanta rajonale apo kombëtare. Pra, nuk duhet të mbetemi vetëm në momentin që ne duhet të vlerësojmë një *ex post* një kontratë, por duhet të futemi në konceptim *ex ante* për të dhënë një këshillë, për të thënë që të drejtat ekskluzive patjetër janë të rëndësishme dhe do të jepen, por duhet të redukton në mënyrë të tillë që të mos cenohet konkurrenca.

Për sa i përket pyetjes së dytë, ju lutem, a mund ta përsërisni nëse është e mundur?

Antoneta Dhima – Nëse Kuvendi i Shqipërisë ju voton për të qenë pjesë e Komisionit të Konkurrencës, a do të ndikoheni ju në realizimin e detyrës tuaj, si anëtar i këtij Komisioni Konkurrence dhe, njëkohësisht, në marrjen e vendimeve?

Durim Kraja – Në radhë të parë, do të them atë që besoj dhe mendoj. Për mua do të jetë privilegj dhe nder në rast se ky komision dhe parlamenti do të më votojë mua për të qenë anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës. Bazuar në kredon time profesionale, morale, si dhe në formimin tim profesional, besoj se do të jem i paanshëm në marrjen e vendimeve, do të më karakterizojë gjithmonë transparenca në marrjen e vendimeve dhe do të mundohem maksimalisht që atë që i jep ligji Autoritetit të Konkurrencës, pra institucion i pavarur në vendimet që merr, ta transmetoj dhe kjo frymë do të karakterizojë vendimet tona që do të marrim.

Patjetër që politika është e pranishme në jetën e përditshme të vendit dhe të gjithë ne jemi pjesëmarrës në një komision, i cili, përtej te qenit komision parlamentar, është komision politik, se të gjithë vini nga parti politike të ndryshme. Në këtë kontekst, mendoj se do të jem i paanshëm në vendimmarrjen time për vetë faktin se e kërkon ligji, për vetë faktin që ne sot, ndoshta nesër ky komision i nderuar, do të marrim në diskutim edhe disa amendime të ligjit, i cili ka vite që po diskuton që ndihmën shtetërore ta kalojë nga ombrella e qeverisë në institucion të pavarur.

Pyetja juaj ka të bëjë me faktin nëse unë do të respektoj apo jo ligjin, ligji e ka të shkruar të zezë mbi të bardhë që të respektohet pavarësia e institucionit, pra në momentin që unë do të respektoj pavarësinë e institucionit dhe do të jem i paanshëm, unë do ta respektoj ligjin maksimalisht. Kjo është një detyrë e të gjithëve ne.

Eduard Shalsi – Nëse pyetjet janë ezauruar, e falënderojmë zotin Kraja për përgjigjet, për marrjen pjesë në konkurrim, duke i uruar mbarësi!

Të bëhet gati kandidatja e radhës, që është zonja Ledia Matja.

Durim Kraja – Faleminderit!

Eduard Shalsi – Kalojmë në dëgjuesën e fundit për sot.

Kemi zonjën Ledia Matja, e njohur për komisionin, pasi ushtron atë funksion dhe detyrë prej disa vitesh, por për ata që nuk e njohin, do të bëni një prezantim të formimit të karrierës tuaj, çfarë ju shtyn të rikandidoni prapë në këtë post shumë të rëndësishëm, pastaj do t'ua kaloj fjalën deputetëve për pyetje. Ndërkohë, kemi kolegë që po e ndjekin mbledhjen *online*, të cilët do të mund të drejtojnë pyetje.

Fjala për ju zonja Matja.

Ledia Matja – I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për këtë seancë dëgjimore dhe për mundësinë që më dhatë për t'u dëgjuar!

Për ata që nuk më njohin, unë kam mbaruar Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës në vitin 1993, me rezultate të shkëlqyera. Mesatarja ime ka qenë 9.9. Kam punuar për organizmat e huaja në Shqipëri, kam qenë konsulente e Bankës Gjermane për Rindërtim, KfW, për shumë vite, gjithashtu nga viti 1998 e tutje kam punuar si pedagoge me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Ekonomik në departamentin e marketingut. Më pas kam kaluar si drejtuese e një projekti shumë të madh të USAID-it për edukimin ekonomik, i cili ishte i shtrirë në të gjithë Shqipërinë. Gjithmonë kam bërë detyra paralele, pra nga ajo kohë e më tutje nuk e kam shkëputur pjesën akademike, ashtu siç nuk e kam shkëputur edhe angazhimin tim me konsulencat ndërkombëtare, ku modestisht kam dhënë kontributin tim për projekte të ndryshme zhvillimore, që kanë qenë pjesë e jetës dhe habitatit shqiptar.

Gjithashtu, kontribuoj me artikuj, me pjesëmarrje në konferenca, të cilat kanë qenë një faktor vendimtar edhe për marrjen e doktoraturës sime në vitin 2014, në universitetin

“Aleksandër Mojsiu” në Durrës, ku edhe kam qenë për njëfarë kohe si lektore, por përsëri me kohë të plotë.

Më pas, në vitin 2017, siç e dini dhe ju, kam kaluar si anëtare komisionere e Autoritetit të Konkurrencës dhe tani dëshiroj ta ripërsëris mandatin tim në këtë Autoritet.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Atëherë, hapim siparin e pyetjeve.

Zonja Dhima dhe zonja Resulaj kanë kërkuar fjalën.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për prezantimin, zonja Matja!

Ashtu sikundër e tha dhe kryetari i komisionit, nuk është hera e parë që ju paraqiteni në këtë komisioni, pasi keni qenë pjesë e Autoritetit të Konkurrencës dhe keni goxha eksperiencë profesionale dhe vite pune në fusha të ndryshme si të administratës, ashtu dhe të mësimdhënies.

Unë kam disa pyetje.

Së pari, ju kandidoni për një mandat të dytë në pozicionin e anëtares së Komisionit të Konkurrencës. Çfarë do të bëni ndryshe nga çfarë keni bërë deri tani për përmirësimin e punës në Autoritetin e Konkurrencës?

Së dyti, cilat janë disa nga pengesat që ju keni evidentuar gjatë këtij mandati ose gjatë ushtrimit të veprimtarisë suaj si anëtare e Komisionit të Konkurrencës? A mendoni se këto mangësi duhen adresuar, për të reflektuar disa ndryshime ligjore në ligjin organik të 2003-shit, me ndryshimet që ka pësuar më vonë?

Së treti, na jepni opinionin tuaj, a ka pavarësi në ushtrimin e detyrës Autoriteti i Konkurrencës, me atë që ju keni parë në këto vite, kur keni qenë anëtare e Komisionit të Konkurrencës?

Së fundi, a mendoni se Autoriteti i Konkurrencës ka kapacitetet e nevojshme për të kontrolluar ndihmën shtetërore?

Shumë faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zonja Resulaj.

Mbajini shënimi!

Pranvera Resulaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, pyetjet e koleges Dhima ishin gati shteruese.

Gjithsesi, së pari, ju përgëzoj që konkurroni për një mandat të dytë! Gjithashtu, ju përgëzoj për eksperiencën tuaj të gjatë!

Mesatarja që ju përmendët ishte shumë domethënëse dhe ka shënjuar karrierën tuaj në vijimësi. Ndoshta do të na i thoni notën që ju ka prishur dhjetën absolute. Kjo ishte për shaka. Ju përgëzoj për formimin tuaj!

Sikundër e tha dhe kolegia, ju jeni duke kërkuar një mandat të dytë dhe sigurisht që tashmë keni dhe një eksperiencë si anëtare.

Si mendoni, pse publiku është kaq paragjykues në lidhje me Autoritetin e Konkurrencës? Pavarësisht se ata që e njohin mirë mënyrën e funksionimit e dinë që nuk është Autoriteti ai që vendos rregullin ose ekuilibrin në treg, por, gjithsesi, publiku është paragjykues.

A mendoni se keni bërë mjaftueshëm për të dhënë të kuptohet se pjesë e detyrës suaj nuk është ekuilibri në treg, por marrja e masave kur kemi një shkelje të këtyre rregullave të tregut, që mund të kenë të bëjnë me marrëveshjet e fshehta, me përqendrimin, me marrëveshjet e fshehta në oligopol, sikundër i kemi përmendur dhe herët e tjera?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Mund të vijoni me përgjigjet, zonja Matja.

Leida Matja – Ju falënderoj!

Për sa i përket pyetjes së parë, se çfarë do të bëja ndryshe, më shumë se çfarë do të bëja ndryshe mendoj t'ju përgjigjem se si e bëj unë punën. Në karrierën time dhe gjatë gjithë mandatit të parë nuk mendoj se kam bërë asnjë gjë e cila është përtej mundësive, kapaciteteve dhe maksimumit të njohurive të mia. Besoj se gjithçka e kam bërë duke pasur parasysh të gjithë formimin tim dhe gjithçka që mund të bëja në këtë pozicion ku jam. Në këtë drejtim, do të vazhdoj të mendoj siç kam menduar, do të vazhdoj të kontribuoj me maksimumin e të gjithë kapacitetit tim intelektual dhe integritetit tim si person, i cili më ka çuar deri në këtë pozicion.

Për pyetjen e dytë, për pengesat e evidentuara në ndryshimet për sa i përket ligjit, dua të them që ne nuk kemi një ligj të keq, kemi një ligj të mirë, të përafuar. Në fakt, asnjë nuk mund të gjykojë ligjin. Ligji është si një veshje e bukur, që ti e shikon, por kurrë nuk e kupton nëse nuk punon me të se sa e ngushtë mund të jetë nëse nuk e provon në trup. Kështu që janë gjithë këta 5 vjet që ne kemi punuar me ligjin dhe kemi kuptuar se cilat ishin disa nga aspektet e ndryshme të tij, të cilat kanë vend për përmirësim. Ne jemi duke e parë. Jemi në procesin e rishikimit të

legjislacionit, për ta bërë atë edhe me koherent, edhe më të përmirësuar, edhe më afër zgjidhjes së problematikave të konkurrencës në Shqipëri.

Për sa i përket pyetjes nëse ka pavarësi në ushtrimin e detyrës, ka pavarësi të plotë. Mund t'ju them që jam një person që vij nga një karrierë akademike dhe kam investuar kaq shumë te vetja dhe te formimi sa që nuk do të lejoja askënd, as politikën, as personat të interferonin në vendimmarrjen time. Kështu që për të gjitha këto arsye besoj se në të gjithë vendimmarrjen time ato që më kanë shtyrë të marr vendime janë vetëm njohuritë, dija dhe kapaciteti im.

Për sa i përket pyetjes: “A mendoni se Autoriteti i Konkurrencës ka kapacitete për ndihmën shtetërore?”, deri tani ka kapacitete për punën që bën dhe ende nuk është folur për ndihmën shtetërore. Ne dimë që kapacitetet që kemi janë vetëm në funksion të ligjit aktual për mbrojtjen e konkurrencës. Për sa i përket ndihmës shtetërore, është diçka që nuk e bëjmë aktualisht.

Për pyetjen e fundit, se përse publiku është paragjykes për Autoritetin e Konkurrencës, kjo është një temë shumë e gjerë, që do të përpiqem ta them shumë shkurt. Publiku dhe të gjithë njerëzit e thjeshtë, pra nëse unë do të isha sot para 5 vjetësh, janë shumë të interesuar për një element që i prek të gjithë, që janë çmimet. Duke qenë se fjala “konkurrencë” shpesh dhe gabimisht mund të lidhet edhe me çmimet, publiku e ka asociuar rritjen e çmimeve me punën që bën ose nuk bën Autoriteti i Konkurrencës, kur, në fakt, nuk është kështu. Autoriteti i Konkurrencës dhe besoj se asnjë autoritet tjetër, përveç rasteve të tregjeve të rregulluara, ku ka monopole, oligopole apo të drejta ekskluzive, nuk mund të rregullojë çmimet. Në tregjet e konkurrencës së plotë, kur nuk ka shfaqje kartelash, kur nuk ka problematika të tilla, të cilat mund t'i rregullojë Autoriteti i Konkurrencës, çmimet i vendos tregu. Në çdo ekonomi të lirë çmimet i vendos tregu dhe çdo ndërhyrje në kërkesë-ofertë nga ana e Autoritetit të Konkurrencës do të ishte ndërhyrje në parimin themelor të demokracisë. Mendoj se kjo është kryesorja.

Eduard Shalsi – Atëherë, duke ju falënderuar edhe për pjesëmarrjen, por edhe për kontributin në Autoritet, ju urojmë mbarësi!

Mbledhjen do ta mbyllim, duke dërguar raportin me kandidaturat për seancën plenare, që do të jetë finalja dhe do të shprehet nëpërmjet votimit.

Edhe një herë, faleminderit të gjithë kolegëve deputetë për pjesëmarrjen, për pyetjet, për dëgjesat, si dhe të gjithë kandidatëve për marrjen pjesë për pozicione, të cilat janë shumë të rëndësishme për ecurinë e institucioneve të pavarura!

Më duhet të them që jemi të kënaqur me cilësinë e kandidatëve dhe me faktin që në një mënyrë apo në një tjetër këto institucione po pavarësohen gjithnjë e më shumë, dita-ditës, çka është një sinjal i mirë për tregun, për konsumatorët.

E kam thënë dhe e kam përsëritur disa herë, më pëlqeu shumë shprehja që dëgjova në një konferencë për konkurrencën, ku një nga legjendat e kësaj fushe, e hapi fjalimin me shprehjen: “Objektivi i Autoritetit të Konkurrencës nuk është konkurrenca, por efienca e tregut, procesi quhet konkurrencë”, çka ndryshonte, po themi, deri diku qasjen dhe mënyrën se si unë dhe të tjerë pjesëmarrës në këtë konferencë i shihnim gjërat.

Kemi kaluar disa momente shumë të vështira dhe jemi përballur me sfida si tërmeti dhe më tej pandemia. Lufta po na vendos përballë zgjedhjesh aspak të lehta, që kanë të bëjnë me këtë kohë inflacioni të lartë. Po shikoja që në Angli ka arritur nivelin rekord në këta 40 vjetët e fundit.

Në këto kohë të turbullta, cili është roli i institucioneve dhe mbi supet e kujt duhet të bjerë pesha? Ndaj, duke i inkurajuar të gjithë kandidatët, pavarësisht se kush do të jenë fituesit, ju rikujtoj se roli i institucioneve të tilla është shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit, për zhvillimin ekonomik dhe në momente krizash roli i tyre merr një peshë edhe më të madhe.

Edhe një herë, faleminderit të gjithë kolegëve!

Do t’ia kalojmë kandidaturat seancës plenare, e cila do të shprehet me votë.

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e Komisionit
Ensemvera Zake**

**Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ
Elvi Prifti**